



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr 385/akti
7

Tiranë 31.07. 2015

V E N D I M

Nr 84 datë 31/07 2015

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhërin e verifikimit
nr. 385/3 dt. 16.06.2015**

Bazuar në urdhrin e verifikimit, sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me ligjin nr.178/2014, ligji nr. 8116 dt. 29.03.1996 "*Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, si dhe mbështetur në nenin 13, 14 gërma "a" dhe 34 të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit" miratuar me Vendimin nr.17 datë 11.03.2015,

VËREJ :

Marrëdhënia e punës së punonjësit ***** pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka filluar në datën 19.01.2009 në pozicionin e Drejtorit të Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe ka vijuar në këtë detyrë deri në daljen e aktit nr. 492, datë 25.07.2012, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, për lirimin nga detyra për shkak të moskonfirmimit të statusit të nëpunësit civil .

***** ka filluar punë me aktin e përkohshëm nr. 335, datë 19.01.2009, në pozicionin e Drejtorit të Shërbimit të Tatimpaguesve në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të

Mëdhenj deri në përfundimin e procedurave të konkurimit për këtë vend pune. Pas kryerjes së procedurave të konkurimit, me aktin nr. 2343, datë 19.11.2010, emërohet në pozicionin e Drejtorit të Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Nga ky pozicion pune është larguar me aktin nr. 492, datë 25.07.2012, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, për shkak të moskonfirmimit të statusit të Nëpunësit Civil. Për këtë arsye, ankuesi i është drejtuar me shkresë ish Komisionit të Shërbimit Civil, i cili, me vendimin nr.144, datë 20.09.2012, ka vendosur:

1. *Pranimin e ankesës së ******
2. *Shfuqizimin e aktit nr.5, datë 25.07.2012, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve në pikën 2/2 ku flitet për ankuesin ***** , si akt i dalë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, duke e konsideruar ankuesin të konfirmuar në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve në Drejtorin Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë.*
3. *Shfuqizimin e aktit nr. 492, datë 25.07.2012, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për lirimin nga detyra të ankuesit, rikthimin në detyrën drejtor në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, si dhe pagimin e pagës që nga moment i i daljes së aktit deri në zbatimin e këtij vendimi.*

Me vendimin nr. 1, datë 09.01.2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 144, datë 20.09.2012, të ish Komisionit të Shërbimit Civil.

Referuar ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, njësia përgjegjëse, në kuadrin e zbatimit të titullit ekzekutiv, vendimit nr.1, datë 09.01.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në momentin që është krijuar një vend i lirë pune, ka emëruar ***** në pozicionin e punës Inspektor i Dytë në Sektorin e Verifikimit në Terren në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, pozicion pune të cilin e ka ushtruar për një periudhë 1-vjeçare. Pas këtij momenti nëpunësi ***** ka vazhduar komunikimin shkresor me institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke kërkuar ekzekutimin e plotë të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, edhe pse ndërkohë e ka pranuar emërimin në pozicionin e punës Inspektor i Dytë në Sektorin e Verifikimit në Terren në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, duke qënë se akti i emërimit në detyrë për këtë nëpunës ishte definitiv dhe jo i përkohshëm.

Në vijim me aktin nr. 259, datë 30.03.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, i cili në mbështetje të vendimit nr. 144, datë 20.09.2012, të ish Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi me vendimin nr. 1, datë 09.01.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka liruar nëpunësin ***** nga detyra si Inspektor i Dytë në Sektorin e Verifikimit në Terren në Drejtorinë, e Kontrollit Tatimor, prnë Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe e emëron Drejtor në Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse në DRTTM Tiranë, për të realizuar përputhjen e nivelit të punësimit, sipas kërkesës së vendimeve të organeve Gjyqësore.

Për shkaqe të pajustificuara, më datën 10.04.2015 (*informacion i marrë nga përmbajtja e procesverbalit të datës 14.07.2015*), nëpërmjet një shkrese drejtuar njësisë përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ***** ka refuzuar të pranojë detyrën Drejtor në Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse në DRTTM Tiranë me arsyetimin se pozicioni i punës Drejtor i Shërbimit të Tatimpaguesve në DRTTM është i lirë që prej tre vjetësh (*referuar deklaratimit të ***** në procesverbalin e mbajtur pranë KMSHC, deklaratim i cili bie në kundërshtim me ankesën dërguar Komisionerit ku citon se për pozicionin e punës drejtor në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, pas kryerjes së procedurave ligjore për emërimin në shërbimin civil është emëruar një nëpunës tjetër, i cili kryen këtë detyrë aktualisht*). Gjithashtu, pas marrjes dijeni për aktin nr. 259, datë 30.03.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, pasi ka informuar për mospranimin e pozicionit të punës si Drejtor në Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse në DRTTM Tiranë, nëpunësi ***** nuk është paraqitur më në punë as në pozicionin në të cilin kishte mbi një vit që punonte si Inspektor i Dytë në Sektorin e Verifikimit në Terren në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Mangësitë e krijuara në zbatimin e ligjit nga nëpunësi ***** , si mospranimi pa shkaqe të arsyeshme i pozicionit të punës si Drejtor në Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse në DRTTM Tiranë, i cili është një pozicion pune ekuivalent me atë të Drejtorit të Shërbimit të Tatimpaguesve në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj apo braktisja e pozicionit të punës si Inspektor i Dytë në Sektorin e Verifikimit në Terren në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, pas daljes së aktit nr. 259, datë 30.03.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, sjell edhe detyrimin e njësisë përgjegjëse për zbatimin e procedurave ligjore (*nga hetimi administrativ kanë dalë të dhëna se për këtë qëndrim të këtij nëpunësi ka filluar një procedim disiplinor, referuar shkresës nr. 15134/1, datë 11.05.2015, i cili nuk ka përfunduar akoma, pasi ai vijon të mos paraqitet në punë dhe në seancat dëgjimore*).

Nisur nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se me aktin administrativ nr. 259, datë 30.03.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, për zbatimin e vendimin nr. 1, datë 09.01.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 144, datë 20.09.2012, të ish Komisionit të Shërbimit Civil, është plotësuar detyrimi që parashikojnë këto akte në përputhje me nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile e parë në këtë kontekst nuk ka më vend për të vijuar procedimin administrativ. Në këto rrethana, bazuar dhe në nenin 34 të rregullores së KMSHC “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, dt. 11.3.2015, duhet të vendoset përfundimi i procedimit administrativ.

Për këto arsye

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” të ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores “*Mbi Procedurat e*

mbikëqyrjes/inspektimit” të miratuar me Vendimin nr.17 dt.11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

V E N D O S A :

Përfundimin e procedimit administrativ të Urdhrit nr. 385/3 prot., datë 16.06.2015 “Për verifikimin e informacionit nr. 385, datë 22.05.2015 të punonjësit *****”.

Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe shtetasi ***** .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA